

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-157/13**

**Prishtinë,  
29 janar 2014**

Në çështjen juridike të:

**N.M.**  
Serbi

***Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese***

**kundër**

***Pala përgjegjëse në kërkesë/ankesë  
Nuk ka***

Kolegji i Apelit për AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarë: Elka Filcheva-Ermenkova , Kryetare e Kolegjit ,Esmë Ertezi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/201/2013 (kërkesa e regjistruar në AKP me numrin KPA34226) i datës 18 prill, 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 29 janar 2014 mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e N. M.e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/201/2013 sipas kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA34226 i datës 18 prill 2013,
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/201/2013 sipas kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA34226 i datës 18 prill, 2013,

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 01 prill 2007, N. M. e ka paraqitur kërkesën në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri posedimin e pronës-lokalit afarist . Ai pretendon se ka qenë pronar i këtij lokali me nr.175 në sipërfaqe prej 9 m <sup>2</sup> në kuadër të tregut të plaçkave në Prishtinë. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai e parashtrroi kontratën për bashkimin e punëve dhe mjeteve i dt.19 nëntor 1997 dhe vërtetimin e dt.16 prill 1998. Pronën ia ka uzurpuar personi i panjohur.
2. Kërkesa është regjistruar me numër KPA34226.
3. Ai pretendon se pronën e ka humbur për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur në Kosovë 1998/99.
4. Më 01 korrik 2009, zyrtarët e AKP-së shkuan te vendi ku ndodhej objekti afarist dhe konstatuan që ai objekt ishte shkatërruar.
5. Sipas raportit verifikues i dt.25 shtator 2008, të gjitha dokumentet e theksuara janë verifikuar negativisht nga ekipi verifikues i AKP-ës me arsyetim se dokumentet para vitit 1999 nuk posedojnë si dhe faktin që ndërmarrja E. D. nuk ekziston më.
6. Më 18 prill 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC) me vendimin e tij KPPC/D/C/201/2013, hodhi poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit. KPCC duke arsyetuar vendimin e tij thekson që, paraqitësi i kërkesës sipas kontratës së theksuar ka pasur të drejtë në ndërtimin e objektit të përkohshme dhe të shfrytëzimit të përkohshëm të asaj strukture- kioskës dhe se prona e kërkuara duhej të konsiderohej si një objekt i luajtshëm .
7. Sipas paragrafit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KPCC, ishte kompetente për të vendosur vetëm për pronat e paluajtshme.
8. Më 17 qershor 2013, vendimi iu dorëzua N. M. dhe i njëjti ushtroi ankesë në Gjykatë Supreme me 08 korrik 2013 (në tekstin e mëtejme: pala ankuese).
9. Ankuesi shpjegoi që lokali afarist ishte një objekt i palëvizshëm, meqë ishte lidhur me tokën në mënyrë permanente. Objekti i ndërtuar është i materialit të fort. Prandaj, vendimi i organit të kundërshtuar është marr me shkelje thelbësore të drejtës procedurale dhe me zbatim të gabuar të ligjit material .

10. Pala ankuese kërkon nga Gjykata që ta anulojë vendimin e KPCC-së sa i përket kësaj çështje juridike dhe ta kthejë të njëjtën në KPCC, ose ta rishikojë vendimin dhe t'i pranoj të drejtat e palës ankuese për kthim shfrytëzimin e pronës.

**Arsyetimi ligjor:**

11. Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).
12. Pas shqyrtimit të shkresave të lendes, pretendimeve ankimore ,sipas dispozitave të nenit 194 të LPK-ës ,Gjykata Supreme gjeti se: ankesa është e pabazuar.
13. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë nga Komisioni në urdhër për kthim në posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon të drejtën pronësore, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojnë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999.
14. Nga kjo dispozitë ligjore rezulton se, juridiksioni i Komisionit për kërkesa pronësore i AKP-ës dhe rrjedhimisht të Gjykatës Supreme është i kufizuar ekskluzivisht për zgjidhjen , gjykimin dhe vendosjen e kërkesave te së drejtës së pronësisë për pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën e paluajtshme bujqësore dhe komerciale. Nuk është kontestuese se sipas Kontratës për bashkimin e punëve dhe mjeteve nr.1991 i dt.19 nëntor 1997 dhe vërtetimin e dt.16 prill 1998 (neni 4 ) ,ankuesi sipas lejes nr.353-697/1 ka pasur të drejtën e shfrytëzimit të qirasë së objektin deri në ndryshimin e destinimit të tokës urbane e pas ndryshimit të destinimit ai ka qenë i detyruar ta dislokojë objektin –kioskën nga qendra tregtare. paraqitësit të kërkesës- palës ankuese i është lejuar që përkohësisht ta vendosë një objekt montazh-kioskin në qendrën tregtare me nr. 175 në sipërfaqe prej 9m<sup>2</sup> në Prishtinë, që është tokë urbane. Këtë objekt montazh i karakterit të përkohshëm paraqitësi i kërkesës ka qenë i detyruar ta dislokojë sipas urdhëresës së organit kompetent me rastin rregullimit të tokës ndërtimore me shpenzimet e veta , pa kompensim dhe pa i siguruar të drejtën në sipërfaqe tjetër gjë që kështu edhe është vepruar nga organi kompetent komunal në Prishtinë.
15. Prandaj, nga kjo gjendje konstatimeve faktike Gjykata Supreme vlerëson se i drejtë dhe i ligjshëm është vendimi ankimor i Komisionit për Kërkesa Pronësore ,kur ka vendosur që të hedhet e palejueshme kërkesa e palës ankuese për mungesë të kompetencës .Kjo për shkak se, sipas aktvendimit të organit kompetent pala ankuese ka pasur të drejtë e vendosjes së përkohshme të objektin montazh-kioskën dhe shfrytëzimit të përkohshëm të atij objekti të karakterit montazh

që trajtohet si send i luajtshëm. Edhe, Gjykata Supreme konsideron se prona e kërkuar sipas dispozitës së nenit 9 par 1 të Ligjit për Pronësi dhe Drejtat tjera Sendore trajtohet send i luajtshëm. Sipas kësaj dispozite ligjore, ndërtesat e përkohshme montazhe, kioskat dhe vendosja e objekteve montazhe të përkohshme siç është rasti konkret nuk konsiderohen sende të paluajtshme. Madje, objekti i përkohshëm nuk mund të jetë çështje e pranimi të drejtës së pronës e as që mund të regjistrohet në regjistrin e pronësisë së zyrës për kadastrë. Prandaj, nga kjo rezulton se janë të pabazuara të papranueshme dhe të kundërligjshme pretendimet e palës ankuese se objekti i përkohshëm montazh i tije është send i paluajtshëm. KKPK-ja ka jurisdikcion në çështjet që kanë të bëjnë me konfliktin sa i përket vetëm pronave të paluajtshme ashtu siq është përcaktuar qartë në Nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

16. Kjo ngase, me faktet e vërtetuara dhe provat e administruara me pa mëdyshje rezulton se, ankuesi në cilësinë e shfrytëzuesit të tokës urbane ka pasur vetën të drejtë shfrytëzimit të përkohshëm dhe rrjedhimisht ndërtimin e objektit të karakterit montazh.
17. Vendimi ankimor nuk përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale.
18. Rrjedhimisht mbi të më sipërmen e me aplikim të ligjit (neni 13.3.C i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore:**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të ankimohet.

***Elka Filcheva-Ermenkova , Kryetare e Kolegjit, EULEX***

***Esma Ertezi, Gjyqtare e EULEX-it***

***Sylejman Nuredini, Gjyqtar***

***Holger Engelmann, Referent i EULEX-it***